



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .03.2024

**MBLEDHJA Nr. 8,
Datë 29.03.2024, ora 13:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 29.03.2024, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 8 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, të ndryshuar.
2. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës shqiptare të furnizuesve të energjisë elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 186, datë 06.06.2023.
3. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e draft “Kontratës për diferencën” (Cfd).

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARE NË DETYRË
Erjola SADUSHI**